

**ISMAIL QEMAL VLORA DHE ELITA POLITIKE SHQIPTARE  
NË PROCESIN E SHTETNDËRTIMIT**

---

AKTE TË KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE



AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
INSTITUTI I HISTORISË



# ISMAIL QEMAL VLORA

DHE ELITA POLITIKE  
SHQIPTARE NË PROCESIN  
E SHTETNDËRTIMIT

Akte të Konferencës  
Shkencore  
Ndërkombëtare  
(27 shtator 2019)

Përgatitja dhe redaktimi  
Prof. asoc. dr. LEDIA DUSHKU

Tiranë, 2021

**ISMAIL QEMAL VLORA**  
DHE ELITA POLITIKE SHQIPTARE  
NË PROCESIN E SHTETNDËRTIMIT  
Akte të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare  
(27 shtator 2019)

---

*Përgatitja dhe redaktimi:* **Prof. asoc. dr. Ledia DUSHKU**

*Komiteti Shkencor i konferencës:*

**Prof. asoc. dr. Ledia DUSHKU** - *Drejtues shkencor*  
**Akademik prof. dr. Beqir META**  
**Akademik prof. dr. Floresha DADO**  
**Akademik prof. dr. Marenglen VERLI**  
**Akademik prof. dr. Shaban SINANI**

*Koordinator shkencor:* **Dr. Sali KADRIA**

*Korrektore letrare:* Mimoza KONOMI

*Treguesi i emrave & Përkujdesja grafike:* Mirela MIHALI

*Kopertina:* Dorina MUKA

ISBN 978-9928-289-61-2

© Akademia e Studimeve Albanologjike (ASA) / Instituti i Historisë  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Për një informacion të detajuar të botimeve të Institutit të Historisë vizitoni  
faqen zyrtare <http://www.asa.edu.al/site/ih/>

Botimet Albanologjike  
Tiranë, 2021

# Pasqyra e lëndës

---

*Pak fjalë për lexuesin*.....7

## **I. Ismail Qemal Vlorë dhe elita politike shqiptare në procesin e pavarësisë dhe shtetndërtimit**..... 15

ROMEO GURAKUQI

Ismail Qemal Vlorë: evolucioni i qëndrimit politik nga viti 1909-1914 ..... 17

ABDULHAMIT KIRMIZI

Imperial subjects with dual loyalties: The Vlorë family between empire and nation..... 43

KALIOPI NASKA

Vizioni dhe politikat e Ismail Qemal Vlorës për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë ..... 57

## **II. Marrëdhëniet me Fuqitë e Mëdha dhe shtetet ballkanike**..... 75

KURT GOSTENTSCHNIGG

Ismail Qemal Vlorë apo Syrja Vlorë? Austro-Hungaria midis tipave të ndryshëm të aktorëve austrofilë ..... 77

LEDIA DUSHKU

Ismail Qemal Vlorë, bashkëpunimi shqiptaro-grek dhe elita politike shqiptare..... 95

VALENTINA DUKA	
Ismail Qemal Vlora dhe institucionet ndërkombëtare që vepronin në Shqipëri gjatë vitit 1913.....	107
ANTON PANCHEV	
Ismail Qemal Vlora dhe lidhjet e tij me Bullgarinë gjatë vitit 1913, sipas dokumentacionit bullgar .....	115
DRITAN HOTI	
Marrëdhëniet me Fuqitë e Mëdha dhe shtetet ballkanike në këndvështrimin e Ismail Qemal Vlorës dhe elitës politike shqiptare.....	129
<b>III. Marrëdhëniet me elitën dhe diasporën shqiptare.....</b>	<b>147</b>
BEQIR META	
Federata Panshqiptare “VATRA” dhe Ismail Qemal Vlora .....	149
SHYQYRI HYSI	
Elita gjirokastrite e Pavarësisë dhe Ismail Qemal Vlora .....	163
LIMAN VAROSHI, MUSTAFA KADZADEJ	
Elita politike e Elbasanit dhe Ismail Qemal Vlora.....	175
RUDINA MITA	
Bashkëpunimi i Ismail Qemalit me Partinë Politike Kombëtare në SHBA, në prag të Konferencës së Paqes në Paris .....	191
<b>Treguesi i emrave.....</b>	<b>209</b>

## Pak fjalë për lexuesin

---

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912, elita politike shqiptare u ballafaqua me sfida dhe dilema të pafundme, më e vështira nga të cilat ishte mbijetesa e shtetit ende të brishtë shqiptar. Koha kërkonte veprime energjike dhe të menjëhershme për t'i dhënë fizionomi institucioneve shtetërore dhe për të zhvilluar e konsoliduar ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve. Koniunktura gjeopolitike, lufta e brendshme politike dhe mungesa e strukturave solide shoqërore bënë që shteti shqiptar të ishte vazhdimisht në sfidë me vetveten dhe të tjerët. Në këtë proces të gjatë e të vështirë, sa sfidues, aq edhe historik, të përcaktuar nga sociologu Ferdinand Braudel “si punë e vetes për veten”<sup>1</sup> roli i elitës mbetet vendimtar. Në këtë kuadër, Ismail Qemal Vlora ishte përfaqësuesi më i zëshëm i elitës shqiptare të fillimshekullit XX, veprimtaria e të cilit shënjoji fillimin e procesit të shtetndërtimit në Shqipëri.

Botimi *Ismail Qemal Vlora dhe elita politike shqiptare në procesin e shtetndërtimit* finalizon produktin e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare organizuar si një sipërmarrje e përbashkët e Akademisë së Studimeve Albanologjike (Instituti i Historisë) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të 100-vjetorit të kalimit në amshim të Ismail Qemal Vlorës. Konferenca e mbajtur në ambientet e Akademisë së Shkencave, më 27 shtator 2019 analizoi me skrupulozitet shkencor figurën e Ismail Qemal Vlorës si intelektual e politikan; rrethanat historike në të cilat ai veproi;

---

<sup>1</sup> Ferdinand Braudel, *Gramatikë e qytetërimeve* (përktheu Fatos Kongoli), Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2005, f. 66.

marrëdhëniet me elitën politike të kohës; kontributin e tij dhe të elitës politike në funksion të çështjes kombëtare dhe shtetformimit; trashëgiminë osmane të një pjese të konsiderueshme të elitës politike shqiptare, mendësinë e kësaj të fundit për shtetin kombëtar dhe procesin e përballjes me shtetndërtimin.

Përmbledhja e paraqitur përmban një numër më të ngushtë studimesh, krahasuar me ato që u paraqitën gjatë ditëve të konferencës. Fillimisht prezantimet u ripunuan nga autorët, në përputhje me kriteret e botimit, e më tej iu nënshtuan redaktimit shkencor e korrekturës letrare nga ekipi që punoi me to. Pikëpamjet e autorëve janë respektuar duke mos cenuar parimin bazë të lirisë akademike. Botimi është i pajisur me aparatën shkencor, me një bibliografi të përmbledhur në fund për çdo artikull, si dhe me treguesin e emrave.

Përmbledhja e akteve është konceptuar në tri pjesë, të cilët ndjekin linjën tematike, në përputhje me shtyllat kryesore të veprimtarisë së Ismail Qemal Vlorës dhe programit të konferencës.

*Pjesa e parë* trajton veprimin dhe ndërveprimin e Ismail Qemalit dhe elitës politike shqiptare në procesin e pavarësisht dhe shtetndërtimit. Profesor Romeo Gurakuqi vjen me një parashtrim ku trajtohet evolucioni i qëndrimit politik të Ismail Qemal Vlorës në periudhën e Kryengritjeve Antiosmane të viteve 1909-1912, si dhe qëndrimi në dy vitet e para të shtetit të pavarur shqiptar (1913-1914). Analiza e punimit bazohet tek qëndrimet publike të bashkëthemeluesit të shtetit. Ato përfshijnë jo vetëm evolucionin e projektit të brendshëm kombëtar, nga autonomia në pavarësi, por edhe skemën evolutive të statusit të Shqipërisë, raportet me vendet fqinje dhe në vijim përpjekjet për të siguruar një qeverisje më të mirë dhe efektive të shtetit shqiptar. Autori ka argumentuar me kujdes se veprimtaria politike e Ismail Qemalit nuk ka qenë një tërësi statike qëndrimesh dhe objektivash, por një sistemim i qasjes politike bazuar në të drejtat kombëtare të shqiptarëve.



Studiuesi nga Turqia, profesori i Universitetit të Ankarasë, Abdulhamit Kirmizi vjen me një kontribut në lëmin e subjekteve perandorake me identitete dhe besnikëri të shumëfishtë. Artikulli evidenton rolin gjithnjë e më të rëndësishëm që shqiptarët luajtën në administratën lokale dhe qendrore osmane, duke u ndalur specifikisht në anëtarët e familjes Vlora, të cilët për shekuj me radhë u zgjodhën në poste të larta drejtuese qendrore dhe lokale osmane. Duke përdorur burime parësore dhe literaturë të pasur, profesor Kirmizi trajton karrierën dhe identitetet e dyfishta që mbartnin anëtarët e kësaj familjeje. Për të, Vlorajt dhe në përgjithësi elitat shqiptare vepruan midis realiteteve paralele që Perandoria Osmane ofronte, duke e konsideruar veten si atdhetarë të dy atdheve (patrias). Në këtë mënyrë, ndërgjegjja kombëtare shqiptare dhe besnikëria perandorake osmane formësuan dy shtyllat e qenjes së tyre identitare .

Studiuesja Kaliopi Naska merr në analizë politikat ekonomike të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ajo evidenton pikësynimin e kryetarit të saj për t'i dhënë hov zhvillimit të tregut kombëtar dhe për të çuar përpara ekonominë shqiptare. Për këtë qëllim, artikulli ndalet në programin ekonomik duke evidentuar dy shtyllat kryesore të tij: zhvillimin e “industrisë shtëpiake”/industrisë së lehtë, si dhe krijimin e një banke kombëtare, që do të ndihmonte në krijimin e sistemit monetar dhe të kreditit në Shqipëri. Prof. Naska sjell në vëmendjen e lexuesit mendimin e Ismail Qemal Vlorës në lidhje me rolin e shtetit, si një mekanizëm rregullues, që duhej të siguronte burimet dhe të ndërtonte institucionet financiare, nëpërmjet të cilave do të harmonizohej dhe gërshetohej funksioni kontabël financiar dhe ai kontrollues shtetëror. Në këtë proces rëndësi i është kushtuar marrëdhënieve të Ismail Qemalit me Fuqitë e Mëdha.

*Pjesa e dytë* vendos në vëmendje të lexuesit marrëdhëniet e Ismail Qemal Vlorës me Fuqitë e Mëdha dhe fqinjët ballkanikë. Studiuesi austriak, Kurt Gostentschnigg vjen me një qasje interesante, ku trajtohen marrëdhëniet e elitës politike shqiptare me Perandorinë Dualiste. Në përpjekje për

t'i vendosur një barrierë pansllavizmit dhe ekspansionit italian, në prag të rënies së Perandorisë Osmane, Austro-Hungaria e pa Shqipërinë e pavarur si aleatën e vetme në Ballkan. Artikulli trajton thukët rrugët e ndjekura nga Vjena zyrtare për t'ia arritur këtij qëllimi, duke u ndalur në një qasje sa teorike po aq edhe praktike të marrëdhënieve të saj me aktorët shqiptarë austrofilë. Me interes shfaqet tipologjia e përvijuar nga autori në lidhje me kategorizimin e këtyre të fundit dhe analizimi i faktorëve që ndikuan në mosrealizimin e interesave të Austro-Hungarisë ndaj shqiptarëve austrofilë.

Artikulli i studiueses Ledia Dushku merr në analizë bashkëpunimin shqiptaro-grek, përgjatë viteve të karrierës intensive politike të Ismail Qemal Vlorës. Strukturimi dhe pesha e këtij bashkëpunimi përcaktohen nga një sërë rrethanash e motivesh, që lidhen sa me karakterin e shumëfishtë identitar që personazhi historik mbart aq edhe me qëndrimin që politika greke mbajti ndaj çështjes dhe shtetit shqiptar. Në punim janë evidentuar qartë dy periudha: e para rrok vitet 1900-1912, kohë kur Ismail Qemal Vlorë besoi dhe u investua për arritjen e një bashkëpunimi shqiptaro-grek; ndërsa e dyta fokusohet në vitet kur Ismail Qemali ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Me interes mbetet trajtimi i marrëdhënieve shqiptaro-greke jo vetëm në aspektin personal, pra të kontaktit që pinjollit i Vlorajve kishte me aktorë të politikës dhe çështjes kombëtare greke, por edhe në atë ndërpersonal, duke i ballafaquar ato me qëndrimin që elita politike shqiptare mbajti karshi tyre.

Marrëdhëniet e Ismail Qemal Vlorës me Fuqitë e Mëdha, konkretisht me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit trajtohen në punimin e prof. Valentina Dukës. Në këtë parashtrësë evidentohen çështjet kryesore, të cilat përvijuan këtë marrëdhënie. Interes paraqet në këtë drejtim trajtimi i rolit të Esat Toptanit, i cili lëvizi fort ushtarakisht, politikisht dhe diplomatikisht për mosnjohjen e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, si qeveri kombëtare. Qasja që Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit pati ndaj Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe kryetarit të saj, konsiderohet prej prof.

Dukës si një nga arsyet kryesore, që dukshëm kontribuoi në rrëzimin e qeverisë së Vlorës, më 22 janar 1912.

Studiuesi nga Bullgaria, profesori i asociuar Anton Panchev vjen me një punim me interes që merr në vëmendje kontaktet e faktorëve të ndryshëm bullgarë (qeveri, ushtri dhe revolucionarë bullgarë) me Qeverinë e Përkohshme të Vlorës. Duke marrë shkas nga dështimi i qartë i Aleancës Ballkanike, me kujdes analizohet ndryshimi i orientimit rajonal nga qeveritarët bullgarë dhe arsyet pse faktori shqiptar personifikohej prej tyre me Ismail Qemal Vlorën dhe qeverinë e tij. Në funksion të argumentit shkencor, në punim pasqyrohen dukshëm relacione të diplomatëve dhe të dërguarve bullgarë në lidhje me situatën politike në Shqipëri, të cilat përbëjnë risi për lexuesit shqiptarë.

Pjesa e dytë mbyllet me artikullin e pedagogut të marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar të Tiranës, Dritan Hoti, i cili fokusohet në rolin e elitave në momentin vendimtar të Shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë. Në qasjen analitike, autori trajton të vepruarit e elitës politike shqiptare, të cilën e përcakton të pajisur me identitet të shumëfishtë dhe të formatuar sipas traditës e filozofisë të shkollave në të cilat ajo ishte formuar. Me interes paraqiten në artikull ndikimi që interesi kombëtar dhe/ose procesi i akulturimit kanë pasur në aksionin politik të Ismail Qemal Vlorës dhe atë të elitës politike shqiptare, gërshetuar kjo me qasjen e tyre përkundrejt Fuqive të Mëdha dhe fqinjëve tokësorë të Shqipërisë.

*Pjesa e tretë* përmban artikuj që kanë në fokusin e tyre marrëdhëniet e Ismail Qemalit me elitën politike dhe diasporën shqiptare. Akademiku Beqir Meta vjen me një kontribut në lëmin e marrëdhënieve me Federatën Panshqiptare “Vatra” në SHBA. Me kujdes analizohet evoluimi dhe luhataja e qëndrimeve të Federatës “Vatra” ndaj Kryeministrit Vlora, shpjegohen arsyet e këtyre qëndrimeve, të cilat për autorin mbartin karakter subjektiv dhe objektiv, jo vetëm parimor, por edhe personal. Analiza kritike e këtyre qëndrimeve sjell përfundime të argumentuara në lidhje me

pasojat kundrejt çështjes shqiptare. Përpjekje janë bërë edhe për identifikimin e faktorëve të jashtëm që kanë ndërhyrë në raportet midis drejtuesve të “Vatrës” dhe Ismail Qemal Vlorës.

Marrëdhëniet e Atit të shtetit shqiptar me elitën gjirokastrite trajtohen në punimin e profesorit të Universitetit të Gjirokastrës, Shyqyri Hysi. Autori parashtron angazhimin intensiv në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, me pikënisje që prej fundit të shek. XX. Me interes paraqitet në punim marrëdhëniet e ngushtë e besimit që elita gjirokastrite krijoi me Ismail Qemal Vlorën dhe mbështetja që i dha aksionit të tij diplomatik për Shpalljen e Pavarësisë, e në vijim në organizimin e forcave të armatosura për mbrojtjen e njësive territoriale, në drejtimin e shtetit të brishtë shqiptar, në organizimin e mitingjeve për mbrojtjen e çështjes kombëtare etj.

Artikulli i profesorit të ndjerë, Liman Varoshi në bashkëpunim me asistentin e tij Mustafa Kadzadej qëndron po në të njëjtin lëmë, atë të marrëdhënies të Ismail Qemal Vlorës me elitën shqiptare, konkretisht me atë elbasanase. Shumanshmëria e shfaqjes së kësaj marrëdhënies ngërthen në përmbajtjen e saj një mori problematikash, të cilat e shndërruan Elbasanin një ndër mbështetësit më kryesorë të Shpalljes së Pavarësisë dhe të qeverisë së dalë nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës. Punimi ndalet në evidentimin dhe trajtimin shkencor të çështjeve, të cilat konsiderohen nga autorët se nuk kanë marrë shumë vëmendje ose nuk janë trajtuar nga rrethet e studiuesve. Të tilla përcaktohen vonesa kohore në aktin simbolik të ngritjes së flamurit kombëtar; procesi evolutiv i shndërrimit të disa prej familjeve feudale të qytetit në familje të mëdha; mbështetja që i ofroi elita politike e Elbasanit Ismail Qemalit dhe qeverisë së tij.

Pjesa e tretë dhe e gjithë përmbledhja mbyllet me artikullin e profesoreshes së asociuar, Rudina Mita, i cili merr në analizë bashkëpunimin e Ismail Qemal Vlorës me diasporën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konkretisht me Partinë Politike Kombëtare atje. Artikulli është i ndërtuar

në dy boshte: i pari ka të bëjë me zbulimin e arsyeve që ngjizën këtë bashkëpunim dhe, i dyti me hapat e ndërmarra për konkretizimin e tij. Sensibilizimi i faktorit ndërkombëtar mbi çështjen kombëtare shqiptare, në një moment tejet delikat sikurse ishte periudha e Konferencës së Paqes pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, konsiderohet nga autorja si shtylla kryesore e bashkëpunimit të Ismail Qemal Vlorës dhe Partisë Politike Kombëtare, ndërkohë që kontaktet diplomatike si mjeti kryesor për arritjen e tij.

Së fundmi, dëshiroj t'u shpreh falënderime studiuesve që iu përgjigjën thirrjes sonë për zhvillimin e konferencës, për prezantimet e paraqitura, pjesëmarrjen aktive në të gjithë debatin e ndjekur, dhe më tej për botimin e akteve të saj. Puna ime si drejtuese shkencore e këtij projekti nuk do të kishte pasur këtë rezultat pa profesionalizmin dhe bashkëpunimin e Komitetit Shkencor të konferencës, akademikëve Beqir Meta, Floresha Dado, Marenglen Verli dhe Shaban Sinanit, si edhe kolegut, dr. Sali Kadria, i cili shërbeu si koordinator i projektit. U jam mirënjohëse për kontributin e dhënë. Një falënderim i ndier shkon edhe për kolegët e Institutit të Historisë dhe Departamentit të Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar, për mbështetjen e vazhdueshme. Po ashtu, i detyrohem thellësisht, Mirela Mihalit, Mimoza Konomit, Meliha Ballës, Dorina Mukës dhe Marsela Metës për ndihmën e vyer që botimi të merrte formën e tij të plotë.

**Prof. asoc. dr. Ledia DUSHKU**  
Tiranë, qershor 2021